



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURES DHE INOVACIONIT
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK ELBASAN**

Nr. 658.Prot

Elbasan më 06.10.2025

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJEREZORE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive", të Udhëzimit nr 759 datë 30.09.2024 Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të Institucioneve ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar të personelit", në Urdherin nr.2837/1.prot "Për miratimin e numrit të Instruktoreve dhe Mesuesve me kohe të pjesshme për vitin 2025" protokolluar në "Qendra e Formimit Profesional Publik Elbasan me nr.120.prot, datë 19.02.2025;

Ofruesi publik i AFP-së Qendrës së Formimit Profesional Publik Elbasan, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- Instruktor/e Siper marrje dhe zhvillimi i planit të biznesit.- **1 person**

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave

penale

- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- b) Të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
- d) Aftësi të tjera nëse kërkohen.

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lire, duhet të përfshijë:

- letermotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në)
- kartën e identitetit
- diplomë
- librezë e punës
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetim të gjendjes shëndetësore
- vërtetimin të gjendjes gjyqësore
- vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;
- dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

2. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofrimit publik të AFP-së brenda datës 14.10.2025

DREJTOR

Krenar XHEMALI

